

*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 28.06.2024*

**28.06.2024**

**Ora, 11:12**

***RENDI I DITËS***

**Për shqyrtimin e kërkesës nr. 2 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për vendosje sanksioni administrativ”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** **Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. I. Rusmali,  
z. Koli Bele.**
  - **Stafi KQZ:** **Znj. M. Koja, z. E. Meta, z. E. Mema.**
- **Parti Politike:** **S’ka prezent**
- **Të tjera:** **KRIIK**
- **Anëtarë të GNV:** **Gerald Çeça, KZAZ nr. 29, QV nr. 2069/00**

**Z. I. Rusmali:** Përshëndetje, riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksioneve administrative, kërkesës nr. 2 të Komisionerit. Seanca rradhën e kaluar u ndërpren pas përfundimit të shqyrtimit tek momenti i shpalljes së vendimit dhe ne sot do të shpallim vendimin. Prezent në seancë përvçe katër anëtarëve të KAS-it, zoti Braho për shkak se ka munguar në shqyrtim nuk është prezent sot, jo se ka pas sot pengesë, por nuk ka qenë pjesë e shqyrtimit. Është administrata e Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve, me personat përgjegjës sikurse ishin dhe në seancën e kaluar. Kemi njeri tjetër? Mund të prezantoheni!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 28.06.2024*

**Z. Gerald Çaça:** Quhem Gerald Çeça, e ndjeva si detyrim që duhet të vija sot në këtë mbledhje dhe dua të tregoj që jam i pafajshëm, e ndjeva se duhet të vija.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, ne e kemi mbyllur shqyrtimin. Ne sot jemi vetëm për shpalljen e vendimit, por prezenca është e rëndësishme edhe për shpalljen e vendimit. Mirë, vendimin e zbardhur të gjithë personat e përfshirë do ta marrin nëpërmjet njoftimit edhe nëpërmjet publikimit. Gjithsesi, në emër të komisionit, unë do të lexoj diçka nga arsyetimi për ta futur në kontekst vendimmarrjen tonë. Pastaj dispozitivin që na takon të shpallim. Ky proces vjen si pasojë e verifikimit paszgjedhor të 10% të kutive të votimit, 526 gjithsej. Nga verifikimi paszgjedhor i KQZ-së, ka seleksionuar vetëm tetë kuti si problematike. Do të thotë statistika në vetvehte është optimiste, është e mirë. Nga ana tjetër gjithashtu do të thotë që vëmendja do të jetë e plotë edhe për natyrën e shkeljeve që prezantojnë këto tetë kuti, se standarti, apo objektivi i KQZ-së dhe administratës zgjedhore do të jetë numërimi, vlerësimi dhe tabulimi pa gabime fare i rezultatit zgjedhor. Ky është objktivi. Gjithsesi në arsyetimin e KAS-it për këto tetë kuti, unë do të evidentoj:

- Në qendrën e votimit nr. 0172/00, shqetësues mbetet heqja e 15 votave nga subjekti “Aleanca Liberale e Djathë” dhe shtimi i 17 votave në favor të subjektit “Partia Socialdemokrate”. Ky përkim forcon dyshimin se në këtë rast mund të jetë bërë zhvendosje e qëllimshme votash, gjë që është e papranueshme për standartin tonë të zgjedhjeve. Pavarësisht se subjekti përfitues rezulton forcë e parë në këtë QV si në numërimin fillestare, ashtu edhe në verifikimin e kryer nga ana e KQZ-së.
- Në QV-1317/00, nga verifikimi ka rezultuar se subjektit “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë” i janë shtuar 47 vota, nga të cilat 38 i janë hequr subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, 7 i janë hequr subjektit “Partia Unititet Kombëtar” dhe 2 vota i janë hequr subjektit “Bartia Balli Kombëtar”.


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 28.06.2024*

- Në QV-1420/05, GNV-ja i ka dhënë padrejtësish subjektit zgjedhor Partia Demokratike 35 vota më shumë. I ka hequr subjektit “Bashkë Fitojmë” 16 vota, subjektit “Lëvizja e Legalitetit”, 8 vota, subjektit “Aleanca Liberale e Djathtë”, 6 vota. Subjektit “Partia Demokracia Sociale” 3 vota dhe subjekteve “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe “Aleanca Progresiste LZHK” nga 1 votë. Duke i shtuar nga ana tjetër subjektit “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” 5 vota. Subjektit “Partia Socialdemokrate” 1 votë dhe “Partia Agrare Ambjentaliste” 1 votë. Ndryshimet e sipërcituara në rezultat nuk i përgjigjen asnjë modeli të pranueshëm të gabimit njerëzor.
- Në QV-1869/01, verifikimi ka treguar lëvizje votash në votimin për kryetar bashkie, këtë rradhë, ndryshe nga gjithë kutitë e tjera. GNV-ja votat e pavlefshme gjithsej 13 copë, pjesën dërrmuese të votave të kandidatit Roland Bejko gjithsej 23 copë dhe votat e kandidatit Marko Dajti 2 copë i ka shpërndarë midis kandidatëve Erion Veliaj 25 copë dhe Belind Këlliçi 14 copë. Kjo lëvizje, gjithashtu nuk shpjegohet dot me gabim njerëzor.
- Në QV-2069/00, nga verifikimi rezulton se GNV-ja një pjesë të votave të pavlefshme 19 copë, një pjesë të votave të subjektit “Partia Demokratike” 10 copë dhe një pjesë të votave të subjektit “Partia Lëvizja e Legalitetit” 3 copë ia ka kaluar subjektit “Partia Republikane” 32 copë. Kjo lëvizje nuk shpjegohet dot me gabim njerëzor.
- Në QV-2272/01, nga verifikimi rezulton se një pjesë e votave të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë” 19, 20 ose 21 nuk mund ta themi me saktësi sepse skenarët janë të ndryshëm dhe eventualisht një votë e subjektit “Partia Socialdemokrate” 1 ose 2 vota të pavlefshme i janë shtuar subjektit “Partia Republikane Shqiptare” 22 dhe subjektit “Aleanca Liberale e Djathtë” 2 vota. Edhe kjo lëvizje nuk shpjegohet dot me gabim njerëzor.


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 28.06.2024*

- Në QV-4016/00, nga verifikimi rezulton se një pjesë e votave të subjektit “Bashkë Fitojmë” 20 copë dhe një pjesë e votave të pavlefshme 6 copë u janë shtuar subjekteve “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” 20 copë dhe “Partia Socialdemokrate” 6 copë. Edhe kjo lëvizje nuk shpjegohet dot me gabim njerëzor.
- Në QV-4455/01, votat për këshillin rezultojnë lëvizje në favor të subjekteve “Bashkë Fitojmë” 11 vota dhe “Partia Demokracia Sociale” 16 vota. Për të shtuar votat tek këta subjekte janë përdorur votat e pavlefshme 9 copë dhe një pjesë e votave të subjekteve “Partia Socialiste e Shqipërisë” 6 copë, “Partia Demokratike” 5 copë, “Partia Republikane Shqiptare” 3 copë, “Partia Socialdemokrate” 2 copë, “Partia Agrare Ambjentaliste” 1 copë dhe “Fryma e Re Demokratike” 1 copë.
- KAS-i i këqyri të gjitha tabelat e rezultateve për QV-të e marra në shqyrtim. Të gjitha tabelat rezultonin të plotësuara pa gabime drejtshkrimore, në përgjithësi me kaligrafi të rregullt dhe pa shkarravitje. Pse e theksojmë këtë fakt? Nëse plotësimi i tyre do të ishte bërë në kushtet e drobitjes, lodhjes së madhe, siç u pretendua nga personat e thirrur në seancën tonë. Drobija me gjasë do të kishte sjellë vështirësi në plotësimin e tabelave.
- Po kështu, KAS-i konstatoi rregullsi në përkimin e shifrave, që është ushtrim shumë i rëndësishëm për të kuptuar nëse grupet e numërimit kanë qenë të kthjellët, apo kanë qenë të shpërqëndruar gjatë plotësimit të tabelave të tyre. Shifrat që hidhen në tabela kanë lidhje me njëra tjetrën, si shumatore ose si diferençë të njëra tjetrës. Drobija mund të shkaktojë prishjen e këtij korrelacioni, sepse lodhja vështirëson kryerjen e veprimeve matematikore. Kjo gjë nuk u vu re në asnjerën nga tabelat e plotësuara.
- Në seancën e pyetjeve me anëtarët e GNV-ve të pranishëm, nuk u ngrit asnjëherë pretendimi, se diferençat mund të kishin ardhur nga shpërqëndrimi për shkak të ngjarjeve apo incidenteve në mjeshterët e KZAZ-së. Pyetjes së KAS-it për këtë situatë,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 28.06.2024*


të gjithë anëtarët e GNV-së që ishin të pranishëm në seancë iu përgjigjën negativisht. Përgjatë procedurave të tyre të numërimit nuk kishte pasur ngjarje apo incidente që mund të tërhiqnin vëmendjen e tyre dhe t'i shpërqëndronin në numërim. Edhe ky mund të ishte një shkak i rëndësishëm që mund të justifikonte parregullsitë, por edhe ky nuk ka ekzistuar.

- Në përgjithësi, lëvizjet e votave në të gjitha QV-të e marra në shqyrtim, indikojnë lëvizje sipas një modeli: pavarësisht se nga merren votat, ato shkojnë masivisht në favor të një ose dy subjekteve të përcaktuara. Kjo lloj lëvizje nuk ka ngjasë të jetë ngatërresë, sidomos kur bëhet fjalë për një numër të lartë votash.

- Mbështetur në këtë arsyetim dhe në parregullsitë e gjetura për çdo tabelë, KAS-i krijon bindjen se justifikimi për lodhje të tejskajshme gjatë kryerjes së procedurave për këto kuti nuk qëndron. Gjithashtu KAS-i konstatoi nga hetimi i vet administrativ se në asnje rast, nga numërimi i këtyre kutive nuk ka rezultuar që të jetë bërë kontestim nga vëzhguesit zgjedhor, i numërimit, apo i tabulimit të rezultatit. Prezenca e vëzhguesve zgjedhorë në procesin e numërimit dhe tabulimit është vendimtare për rregullsinë e procesit. Vëzhguesit janë aty që të ruajnë se si sillen dhe veprojnë numëruesh. Në qoftë se vëzhgimi nuk ka funksionuar ky faktor duhet të merret për bazë si faktor lehtësues për numëruesh, jo si ngarkesë për ta. Sistemi funksionon si i tërë, në qoftë se një hallkë nuk funksionon, gabimi është i asaj hallke, jo i pjesëve të tjera të sistemit. Për të gjitha këto arsy, KAS-i pas shqyrtimit, në përfundim vendosi:

- Pranimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj anëtarëve të GNV-ve që kanë numëruar kutitë e votimit që përmenda më sipër, nuk po i rreshtoj, në vendim janë të rreshtuara.
- Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë, në masën njëzet mijë lekë për secilin anëtar të GNV-ve për QV-1317/00, vijojnë emrat nuk po i përmend në respekt të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 28.06.2024*

mbrojtjes së të dhënave personale, për kaq sa i përket kësaj seance. për QV-1420/05, për QV-1869/01 dhe për QV-2069/00.

- Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë, në masën pesëmbëdhjetë mijë lekë për secilin anëtar të GNV-ve, për QV-0172/00, për QV-2272/01, për QV-4016/00 dhe për QV-4455/01.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij.
- Palëve të pranishme, njoftuar me shpalljen, ju keni marrë dijeni. Palëve të tjera do t'ju bëhet e qartë nëpërmjet njoftimit.
- U shpall sot në datë 28.06 2024.

Me kaq seanca deklarohet e mbyllur, faleminderit!

**Vendimi nr. 13**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

